



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

---

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY  
ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës se Istogut, mbajtur më: 08.10.2020 (e Lartit), ne sallën e Kuvendit te Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                           |                               |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK;      | 14. Misin Berisha, AAK;       |
| 2. Zenel Shatri, LDK;     | 15. Eliot Kukiqi, AAK;        |
| 3. Besa Ferati, LDK;      | 16. Ardita Idrizaj, AAK;      |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;    | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK;     |
| 5. Njomza Demaj, LDK;     | 18. Labinot Aliaj, PDK;       |
| 6. Haki Podrimaj, LDK;    | 19. Arben Kabashi, PDK;       |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK;  | 20. Mirushe Sadikaj, PDK;     |
| 8. Riza Dreshaj, LDK;     | 21. Lavdije Bujupaj, VV;      |
| 9. Ruzhdi Metaj, LDK;     | 22. Agron Avdijaj, VV;        |
| 10. Valbona Demaj, LDK;   | 23. Arif Elshani, IQ;         |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK;  | 24. Radoš Repanović, SL;      |
| 12. Naim Imeraj, AAK;     | 25. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Nexhmedin Balaj, AAK; | 26. Slaviša Maliković, SM.    |

Në mbledhje të ishin të pranishëm Drejtore të drejtive të komunës, zyrtarë komunal, dhe media (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e jashtëzakonshme, të Legjislacionit të VI-të bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Statutin e komunës dhe kërkesën e anëtarit të Kuvendit z. Agron Avdijaj. Dihet së në mbledhjet e jashtëzakonshme sipas rregullores dhe ligjit është një pikë e rendit të ditës ku diskutohet dhe debatohet lidhur me aprovimin apo mos aprovimin e saj.

### Rendi i ditës

1. Raportimi mbi gjendjen dhe procesin e fillimit të mësimit në shkolla nga Drejtoria e Arsimit.

**Kryesuesi**, njoftoi se për këtë mbledhje munguan 1 (një) anëtarë e Kuvendit znj. Ajshe Metaj, me lajmërim. Gjithsej në mbledhje ishin të pranishëm 26 (njëzetë e gjashtë) anëtar të KK.

### Shqyrtimi i pikës së rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, mbledhja është e thirrur nga 1/3 e anëtarëve të kuvendit me kërkesën e z. Agron Avdijaj – VV.

Fjalën ia përcjell propozuesit të rendit të ditës z. Agron Avdijaj.

**Agron Avdijaj** – përshëndet të gjithë të pranishmit, mungesa e kryetarit e zbehë pak seancën e sotme

**Kryesuesi i Kuvendit** – kërkoj falje Agron kryetari besoj që shumë shpejt do të na bashkëngjitet sepse ishte në një takim, Agron do të jetë këtu së shpejti.

**Agron Avdijaj** - sqaron procedurën dhe arsyen e thirrjes së mbledhjes së jashtëzakonshme.

**Hajrush Shoshi, drejtor i Arsimit** - përshëndet të gjithë të pranishmit, njofton anëtaret e Kuvendit më raportin e Arsimit dhe gjendjen aktuale me pandeminë Covid 19.

**Agron Avdijaj** – natyrisht disa informata që i prezantoj drejtori edhe nuk i kemi pasur, raportimi është dashur të jetë edhe pa thirrjen e seancës së jashtëzakonshme, me i raportuar paraprakisht këto megjithatë unë i kam ehe disa vërejtje dhe shqetësimë që këto pak a shumë janë të lidhura edhe me shqetësimet e disa mësimdhënësve dhe prindërve aty këtu lidhur me këto çka drejtori i përmendi, jeta e fëmijëve, nxënësve dhe mësimdhënësve gjatë pandemisë është krejtësisht e ndryshme me nga ajo që ka qenë me herët prandaj me shumë se për çdo herë tjetër përqendrimi i institucioneve edukativo-arsimore duhet të jetë tek shëndeti dhe

mirëqenia e nxënësve dhe mësimdhënësve, ne natyrisht duke u bazuar në ketë edhe e kemi bëre ketë thirrje të seancës sipas të dhënave dhe shqetësimeve të pranuara gjatë kësaj kohe janë paraqitur edhe vështirësi edhe situata të cilat konsiderohen që nuk janë trajtuar dhe menaxhuar si duhet dhe sa duhet gjatë kësaj kohe.

Të flasim fillimisht me transportin e mbingarkuar të nxënësve nga shtëpitë e tyre lagjet apo fshatrat deri tek shkollat, mungon koordinimi mes drejtorive dhe kompanive të transportit të inspektoratit së është numri i atyre nxënësve që hyn nëpër autobusë kur dihet se distanca është e domosdoshme të mbahet aty besoj e keni vërejtur të gjithë ju që nuk është në nivelin e duhur transporti i nxënësve nga vendbanimi në shkollë e anasjelltas, organizimi i ndërrimit në tri ndërrime është ber me qellim qe të evidentohet grumbullimi i madhe i nxënësve në një periudhë të njëjtë kohore mirë po pavarësisht që është bere 8 - 11 pastaj është lenë gjysmë ore, të transporti mirë po kjo vlen edhe të gjimnazi ku numri i nxënësve është me i madhe, ku shumë nxënës për me ardhë në ndërrimin e par me i nxënë orët e ndërrimit të par duhet me ardhë me autobusët e mëngjesit e aë i bie me huj kohë dv orë apo ku ta di unë që do me thëne munden me u ekspozuar, d.m.th e njëjtë vlen edhe ndërrimin e dytë që duhet të vijnë ndërrimi i tretë me ndërrimin e dytë që ti zëne orët si duhet. Ka nxënës që ankohen që ndërrimin e dytë nuk kanë mundur me i zëne orët e para dhe e lenë dhe nuk vjen fare në mësim, ndoshta këto të dhëna i ka me mirë drejtori të prezantuara, por ne këto i kemi marr nga disa mësimdhënës për ketë unë propozoj që të koordinohet dhe të mundësohet transporti i nxënësve me autobus apo kombibus duke u bazuar edhe në orarin e mësimit siç është përcaktuar në tri ndërrime ketë besoj që kish mundur me një organizim edhe me të mirë me bë Komuna e Istogut, ka pasur probleme fillestare në shenjëzimin e hyrjes, mirë po kjo me kohë si duket është evidentuar, materialet masat mbrojtëse, drejtori tha që në disa shkolla janë ardhur në momentin e fundit që pak a shumë kjo krijon pak kaos në organizim dhe fillimet e procesit mësimor për kundër furnizimit të mjaftueshëm ndoshta në disa shkolla janë vërejtur mungesa e gjerave higjienike jo në të gjitha shkollat por në disa sepse disa e menaxhojnë me mirë ketë situatë.

Identifikimi i mësimdhënësve me Covid pozitiv ne saktësisht nuk e kemi ditur sa ka qen numri i tyre përvëç disa deklaratave që kemi pasur këtu mirë po tash nga raporti e kuptuam se cilat janë masat që drejtoria ka ndërmarr për to pse ka vendos skenarin me e vazhduar ku ka raste komunat që ju ka identifikuar dy mësimdhënës dhe ka mbyllë shkollën, edhe pse në Istog e kanë parë të arsyeshme të vazhdohet për kundër që janë identifikuar me shumë raste me Covid hapësirat e brendshme të institucioneve arsimore dhe edukative u tha që janë dezinfektuar fillimisht mirë po sipas udhëzimit parashihen që dezinfektimi duhet të bëhet edhe në mënyrë të vazhdueshme jo të mbetet vetëm me një here, edhe nga informatat që kam nuk është bërë ndonjë dezinfeksion i objekteve përvëç pastrimeve normal që bëhet nga mirëmbajtësit dhe punëtoret teknik të shkollave disa klasa kemi informata që janë të mbingarkuara me më shumë se mbi 20 nxënës e udhëzimi për ketë e parashev që maksimumi të jetë deri në 15 e deri në 20 mirë po ka tejkalim të këtyre. Kisha propozuar që shkollat që kanë me shumë qarkullim të shikohet mundësia pse mos të vendoset edhe një kabinë dezinfektuese në hyrje të shkollës, shumë objekte dhe

hapësira para se të filloj mësimi ka pasur nevojë që të gëlqerosën para mësimit, mirë po ka salla e shkolla që nuk janë gëlqerosur para fillimit të procesit mësimor , natyrisht që edhe kjo pastaj e bën edhe higjenën me të vështir.

Lidhur me identifikimin e mësimdhënësve të cilët janë me të moshuar ose që kanë probleme shëndetësorë e që janë liruar ose që duhet të lirohen nga përgjegjësia e ushtrimit të detyrës gjatë kësaj periudhe nuk e dimi numrin a është liruar ndonjë dhe sa janë liruar dhe nëse janë liruar si është bere me zëvendësimin e tyre sepse po ka vështirësi në zëvendësimin e orëve në mungesë të tyre. Unë sa pashë ish dalë edhe një konkurs mendoj që ka mundur të dal edhe me herët është i vonuar që ka qen konkursi për plotësimin pikërisht për këtyre orëve mendoj se këtu drejtoria ka mundur të jetë me e organizuar, po ashtu meçen së pastërtia në një faze është shumë e domosdoshme me intereson të di a është rritur personeli në shërbimin teknik (pastruesit dhe shërbimit tjera teknike në shkolla) për mirëmbajtjen e tyre apo thjeshtë janë numri i njëjtë i tyre dhe nëse është numri i njëjtë i tyre është shtuar numri, një shqetësim tjetër që unë e kamë edhe nga prindërit sidomos edhe mandati i këshillit të prindërve në shkollat fillore por edhe të mesme emërohen mirë po nuk kanë as një ndikim apo përfshirje reale përveç procedurës ligjore me e plotësuar si kriter, por çuditërisht pastaj drejtoret formalisht edhe thirren nëpër këshilla të prindërve kishe që janë marr edhe pajtimet e prindërve për këto kemi konfirmimi edhe nga prindër që janë pjesë e këshillave të prindërve neper shkolla të caktuara e që nuk janë njoftuar nuk kanë marr as një thirrje as një krekës për takim ose diçka tjetër tash nuk e di se si funksionon kjo brenda shkollave, ndërsa në udhëzim njëra nga detyrat dhe përgjegjësit nga drejtoria e arsimit është që të komunikoj në mënyre efikase dhe të sigurt në këshillin e prindërve në nivele komunale ( në nivel të shkollave o fjala) këto janë pak a shumë që kanë lidhje me taks forcat sigurisht që janë kërkuar të formohen drejtori tha që janë formuar unë nuk e kamë pasur ketë informacion apo janë informuar mirë po përveç informimit a është duke u kryer puna si duhet edhe i taks forcës edhe i këtyre në raport drejtori taksforc edhe drejtori e komunës këtu po ashtu sipas udhëzimit parashihet edhe të vlershmi i situatës epidemiologjikë ku do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme nga taksforca e shkollës edhe kjo do të duhet që të behet dy here në javë këto janë pak a shumë ato shqetësimet që janë vërejtjet periudhën e fundit.

**Labinot Alijaj** – pëershëndet të gjithë të pranishmit, duke qen së që nga fillimet e pandemisë jam në takime të rregullta me drejtorin, dëshiroj të ja kujtoj se donacionin e parë të maskave, e ka marr nga grupei vullnetar Covid 19 meqë nuk e përmendi këtu pasi që i tha disa nga donacionet që i ka marr.

Pyetje për drejtorin për raportimin në media për testimin e në baza partiake deh shoqërore të them me ndryshe nga Klanet e afërtë me drejtoret e shkollave dhe pyetja ime është se a mund të dimi se cila është përzgjedhja e profesorëve dhe mësuesve të cilët janë testuar për fillim nga dhjetë për shkolla si dhe nuk e dëgjova që tha drejtori që është pjesë e taksforcës edhe komandanti i Policisë edhe kjo është një pyetje a është apo nuk është, nëse nuk është përfshirë komandanti i Policisë në një taksforcë e vijmë të ajo që tha edhe kolegu Agron që problemi kryesor është tek

bartja e nxënësve ku unë kam vërejtur shumë autobus ku kanë sjellë grumbull të madhe të nxënësve ku nuk kanë pasur as maska të vendosura, ky është shqetësim i shumë qytetarëve edhe prindërve, do të doja të merret edhe në shqyrtim që pjesë e taksforces të behet edhe komandanti i policisë për arsyen që këto kompani duhet të kenë kontakt me dike nga taksforca dhe që komandantin i Policisë do ta kryente me mirë ketë punë dhe mos të ketë lëshime dhe rritje të numrit të te infektuarve.

**Arben Kabashi** - përshëndet të gjithë të pranishmit, thirrja e seancës së jashtëzakonshme me thëne të drejtën me shumë edhe është politike në ketë rast se sa diçka që me kërkuar një raportim, pse po e them ketë edhe pse e kam dhënë nënshkrimin me e thirr një mbledhje të jashtëzakonshme. E kam dhen pse kur e dini që PDK gjithnjë në Istog ka gjetur bashkëpunim me çdo parti politike për çështje të ndryshme për çdo gjë jemi të gatshëm me bashkëpunuar me çdo parti politike në Istog. Desha me ja rikujtuar edhe Agronit që tjetër here mos të heziton kur të kemi çështie me të rëndësishme n.sh sic kanë qenë vlerat e luftës aë nuk na ka dhen nënshkrimin me e thirr mbledhjen e jashtëzakonshme pra që ka qen kundër edhe me e thirr edhe që ka ardhur ne asamble dhe ka votuar kundër, ka kërkuar kritere që nuk u bejke. Ne si PDK jemi bashkëpunes me çdo parti politike në komunën tonë. Por kur jemi të raportimet me qen pak me real ne kemi mundur edhe seancën e rregullt me ja kërkuar çdo drejtori për me e dhen një raport mbi bazën e asaj qe e kérkon, shqetësimet që i ngriti Agroni janë shumë me vend po me shumë i quaj shqetësime teknike se organizative, pse po e them ketë të gjithë jetojmë këtu të gjithë kemi fëmijë dhe familjar qe i kemi neper shkolla unë besoj që çdo shkollë janë marr masa duke ja nisur nga ato higjenike që janë masa parandaluese të Covid 19 këto i kemi parë por çështjet teknike që Agroni i ngritet me të vërtet janë si ajo bartja e nxënësve deri të shkolla orari pasë orës 12 që është edhe ndërrimi i dytë çka mund di, pra janë shqetësime çka munden bashkë me këto taksforcat e me policinë, taksfrcat e shkollave që munden me bë një organizim me të mirë rrethe tyre, unë nuk kam diçka vetëm se pata punën me e sqaruar puna e nënshkrimit dhe thirrjes së Asamblesë. Se nuk po e shohë qe ka diçka vendim me e thirr një mbledhje të jashtëzakonshme e me e marr një vendim për diçka.

**Zenel Shatri** - përshëndet të gjithë të pranishmit, për mendimin tim kjo mbledhje siç tha edhe Arbeni është me shumë politike, iniciativa e Agronit sepse nuk ka qen e nevojshme fare. Kur e kamë marr thirrjen jam befasuar shumë për këtë mbledhje. Pse ! për raportime të tillë ne mundemi me e lypë çdo mbledhje që e kemi aty pikën e fundit pyetje e përgjigje, dhe kemi mundur ta pyesim z. drejtor për gjendjen në komunën tonë për arsim kështu që nuk e shohë të arsyeshme vetëm për këto shqetësime që u thanë tash sa për këto me siguri edhe drejtori ka për me i thëne unë mendoj që komuna jon qëndron në nivel mjaftë të lartë jo vetëm të arsimit por edhe të shëndetësisë, pasi që unë jam edhe i lëmis kryesisht i lëmis së ngushtë të kësaj sëmundjes infektive Covid 19 e që është pandemi faktikisht ka mbërri krejt rrugullin tokësor mendoj që Istogu qëndron në nivel mjaftë të lartë mund të them në nivelin e

tri katet komunave që janë me mirë për ndryshe ne jemi shumë me mirë, duke ju falënderuar shtabit në krye me Kryetarin dhe anëtaret e tjerë.

Sa i përket përgatitjes për fillimin e vitit shkollorë, tash mund të jetë edhe një çështje teknike siç e ceku kolegu por unë mendoj sepse edhe vet kam qenë prezent në disa shkolla. Mendoj që niveli për përgatitjen e fillimit të vitit shkollor ka qenë nivel mjaftë të lartë për kushte dhe rrethanat tona që jetojmë dhe mbesim.

Bartja e nxënësve unë udhëtoj çdo ditë të gjithë i kemi fëmijët e punësuar ndoshta mund të rregullohet por po shohë mjaft autobusë, sa i përket Gurrakocit aty është njeri që i bartë nxënësit a ka kontrata me MASHT a jo nuk di, por unë shohë mjaft rregull e mbanë distancën në një far mënyre 3 a 4 here në dite udhëton i pret nxënësit dhe nuk e bën tollovi po flas vetëm për rajonin tim, sepse policet nuk mund të rrinë në çdo skut e të ruajnë a e kanë vendosur maskën nxënësit a jo, po shqiptojn mjaft dëname e gjoba po i shoh tu i shqiptu mirë po, ne jemi popull i tillë edhe nga një here i thejmi ato rregulla edhe ne vet qe merremi me atë problematik i thejmi ato rregulla kështu që unë e shohë të na arsveshme ketë mbledhje e shohë thirrje politike ose për mëditje dikush qe ka dëshirë për me marr, për mendimin tim kjo nuk ka qen e nevojshme kjo thirrje sepse ka pas mundësi me e kërkua një raport te tillë edhe në mbledhjet e rregullta që i mbajmë për çdo muaj.

**Arif Elshani** - përshëndet të gjithë të pranishmit, unë mendoj sa i përket ftësës së Agronit me të vërtet sot u bë politike se atë ditë nuk ka qen politike e drejta e Agronit dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit është për me e thirr një mbledhje dhe mendoj që shumë mirë ka bërë qe e ka thirrur dhe unë do ta përkrah çdo here Agronin edhe të gjithë ata që e thërrasin mbledhjen një mbledhje të tillë, edhe nuk ke shumë e rrugës që ne aq shumë të kontestojmë ftësën e kësaj mbledhje nga Agroni pavarësisht se cilit subjekt i përket dhe aj është i joni e lexova raportin edhe nuk pash askund në raport, apo ndoshta nuk e dëgjova, sa ka qen aktiv roli i këshillit të prindërve në ketë pandemi dhe në ketë aktivitet a kanë qenë prindërit të angazhuar a kanë marrë pjesë këshilli i prindërve, si funksionon këshilli i prindërve, unë mendoj që këshilli i prindërve ka qenë pjesë e këtij aktiviteti, edhe nëse ka qenë pjesë ndoshta është dashtë në atë raport a është në përbërje të këtij këshilli i prindërve taksforce a nuk është po me interesin. unë mendoj të gjitha shkollat një rol shumë të veçantë e ka këshilli i prindërve, pse mos ti dhëm ne fuqi edhe në komunën e Istogut këshillit të prindërve pavarësisht se kush është në atë këshill të prindërve. Po jua jap një shembull komuna e Prishtinës edhe përzgjedhjen në konkurs e përfshin edhe këshillin e prindërve, e përdorin shumë komuna në Kosovë prej këshillit të prindërve edhe përzgjedhjen në konkurs të arsimtarëve ne duhet ti dhëm një përparësi këshillit të prindërve se aj është një rol shumë dominant në çështjen e arsimit.

E Agron sa here të thirr unë ta dha votën.

**Agron Avdiaj** - fillimi shqiptar për Arbenin atë qe e përmendi nënshkrimin Arben unë kur kamë ber ftësë me e nënshkruar ketë kamë kërkuar edhe mendimin tënd a ta merr mendja me plotësuar çka të thuash ti të i inkorporojmë këtu ndërsa kur i ki pru

ti ma ke mohuar. Të kom than unë e votoj po të bëjmë një përmirësim të vogël nuk e ki pranuar ki thëne se veç kështu duhet unë prape në ketë rast kamë qen me fleksibik se sa ti.

Ndërsa sa i përket thirrjes politike ne jemi edhe institucion politik, kushdo që të thërret e ka mbrapa një parti e ka diçka mundeni me ja vesh sa here doni mirë po unë nuk pajtona se janë çështje teknike po edhe nëse janë çështje teknike, këto çështje teknike po ti bin problemet ty, as me pak unë prej doktorit nuk e kisha pritë që ketë me e thëne nëse çështja teknike nuk ka ndikim, mundësia e infektimit të popullatës është gabim shumë i madhe, sepse pikërisht prej detajeve të vogla lindin problemet e mëdha.

Thirrja e kësaj seance ka qen me i ndihmuar drejtorisë së Arsimit e jo me e kritiku e me e varsu, sepse unë kam kritika hala me të ashpërtë në atë kuptim mirë po mi zbuta pak nëse është e nevojshme me ja pri drejtorit apo dikujt që ka dyshime me fotografi me ndodhi me sene me video me i prezantuar këtu me i mbledh mediat, ajo kishte me qenë politike, e që realisht kemi edhe as po aë unë nuk po dua me ra atë nivel, prandaj mendoj që nuk është e drejtë me thëne që është çështje teknike ka mundur me qen raportim, situata e pandemisë nuk mund ta lësh një muaj ditë sepse infektohet popullata edhe pas një muaj mbajmë mbledhje sa të duash pastaj.

Zenel Shatri, aq më pak unë çdo herë jam i prirur dhe i njohur se unë jam i partisë së LDK-së edhe i mbroj interesat e partisë, mirëpo nuk jam edhe aq shumë me 'ashkëselat' ti Avdijaj, e dimë arsyen pse po them politike e din pse, e dyta për çështje politike unë mendova ndonjë cikërrimë, ju nuk na e dhatë atë në asnjë rast, drejtori na i tregoi gati të gjitha, dhe gati të gjitha ishin në nivel, aty këtu ndonjë çrregullim mund të jetë por diçka më shumë nuk pashë, edhe prej teje nuk dëgjova diçka shumë serioze, p.sh jo autobusët, unë e di që janë autobusët i kam parë të tregova, për fshatin tim të tregojë, konkretisht ai udhëton 5 herë në ditë me pak nxënës hyn me maska i shoh të gjitha. Në Gurrakoc këshilli i prindërve funksionon shkëlqyeshëm, unë e di që ka bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe është në nivel nuk dëgjova diçka konkrete. E dyta sa i përket kohës, ne para një jave e kemi pasur mbledhjen tjetër, kemi mund me kérkuar një raport të tillë.

**Kryesuesi**, drejtori po e kérkon fjalën lidhur me disa sqarime dhe pastaj vazhdojmë më tutje.

**Hajrush Shoshi**, veç për shkak që mos të bëhen shumë pyetje, dhe do t'i përgjigjëm me radhë. Sa i përket raportimit as kur e kam marrë ftesën nuk kam thënë që është raportim politik, por është kérkesë e juaja dhe për mua është e drejtë me e ditë edhe ju se çka duhet, çka është punuar si është punuar, ka mund edhe në kohë tjetër p.sh me datën 29 kur e kemi pasur mbledhjen që ta kom një raport ka mund edhe në fund të muajit, me gjithatë kjo mbledhje është thirrur, kështu që ne jemi këtu. Sa i

përket transportit të nxënësve kemi një koordinim jashtëzakonisht të mirë me Stacionin Policor në Istog, e kanë orarin e të gjitha shkollave, e kemi dorëzuar zyrtarisht orarin e mësimit, edhe e monitorojmë në mënyrë të vazhdueshme, thashë edhe raportin që e kanë dërguar i ka inspektuar të gjitha shkollat një ekip policore civil që nuk kanë ditë askush se çka janë dhe e kanë bërë raportin vet, siç e pat në fund. Ka transportues që është dënuar prej policisë për shkak të numrit të mbingarkuar të nxënësve d.m.th edhe ajo pjesë është duke u mbikëqyrë nuk po them që është mirë, binduni që është vështirë që 7900 nxënës të bartën dhe të organizohet një transport që ata me e ruajt një distancë 1.5m. Edhe ne sigurisht edhe Ministria ka paraparë që do ta marrim një risk të rrezikut për hapjen e shkollave. Rasti mbylljes së shkollës që u fol shumë, shiko ku e kemi protokolli i reagimit ndaj pandemisë Covid-19 në shkolla thotë kështu: niveli i shkollës në rast të infektimit për 200 nxënës në ditë gjatë një javë, nëse është një rast i infektimit gjatë një javë, çdo ditë nga një, në një shkollë që i ka 200 nxënës ilustrim e kanë bërë, nëse një shkollë me 1000 nxënës ka më shumë se 5 raste të infektiveve të reja brenda një ditë qiatë 3-5 ditëve të punës atëherë mbledhet task forca. Ditën kur ka ndodhë ne e kemi mbajtur takimin me task forcën komunale në ora 17:00, kemi kontaktuar edhe me ministrin e Shëndetësisë edhe nuk kanë dhënë asnje rekondit. D.m.th ka mbetur që të vazhdojë mësimi, më besoni edhe shumë prindër më kanë thënë mos na i i mbylli shkollat, është shkolla më e madhe mirëpo fatmirësisht asnje mësimdhënës nuk ka ndonjë simptomë të rendë të infektimit, të gjithë janë te shtëpia janë mirë, janë duke e mbajtur edhe mësimin online. Sa i përket furnizimit, mund të ju them lirisht për furnizim për mirëmbajtje të shkollave në takimin e parë që e kemi pasur është zgjedh nga drejtorati Sami Metaj edhe Naim Sadrijaj me u koordinuar me të gjitha shkollat edhe ju them me plot përgjithësi se Naimi për çdo ditë merr raporte ditore, raportet ditore nga dy herë në ditë, ne si DKA raportojmë në inspektoratin e Arsimit në Pejë. D.m.th çdo ditë na fton dy herë në ditë në ora 08:00 dhe 15:00. Sot pa ardhur në mbledhje e kam pasur thirrjen, nuk po them që gjithçka është në rregull, se as ne këtu nuk jemi në rregull me thënë realisht, as ne nuk e kemi distancën e duhur. E dyta sa i përket dezinfektiveve, materialeve kanë sa të duash. Ai drejtor që thotë nuk kam për mua e ka gabim mos të bëhemë krejt. E dyta sa i përket dezinfektiveve materialeve kanë sa të duash aj drejtor që thotë që nuk kamë për mua e ka gabim dje kanë thirr kanë shpërndarë prapë maska , kemi maska të mjaftueshme, kemi dezinfektues, më vjen keq se ka edhe shumë donatorë të ndryshëm Lab, po nuk e kemi përmendur se ka edhe plot donatorë i kemi përmend këto dy raste që janë pak më të mëdha sepse na kanë ndihmuar shumë përndrysht për çdo ditë ka donacione edhe prej prindërve , e kam bërë ndoshta lëshim se në rapport nuk e kam përmend kryetarin e këshillit të prindërve që ka qenë së bashku me neve me përfaqësuesin e Ministrisë me datën 12-13 tërë ditën me neve ka qenë. Edhe ai e ka ftuar këshillin e prindërve, ka bërë telefonata e ka bërë një postim në facebook , kështu që këshillat e prindërve në të gjitha shkollat nuk më është dukur që është çështje për raportim. Sa i përket ndikimit të këshillit të prindërve në shkollaasnje vërejtje se kam, kush do që e ka një problem është mirë me e sjellë vërejtjen në drejtorat, është mirë te raportoni në drejtorinë komunale të arsimit, derisa vijnë

raportet e mira, derisa ata e kanë gjetur një bashkëpunim për mua është në rregull. Mirëpo kanë të drejtë lirisht sepse kryetari i këshillit të prindërve ka ndikim jashtëzakonisht të madh në shkolla, edhe duhet të ketë se ne trekëndëshi, prind-mësimdhënës- nxënës, duhet të funksionojë edhe në shkollat tona ashtu si funksionon në të gjitha shkollat. Lidhur me mësimdhënësit që probleme shëndetësore ne, ministria e arsimit, në bazë të master planit na i kanë ndarë 64 mijë euro për këtë vit të cilat janë alokuar javën lëmë pas. Edhe në momentin që i kemi parë mjetet që janë në Ilogari, e kemi hapur një konkurs që t'i pranojmë 25 punëtorë të profileve të ndryshme, ndër ta ka edhe punëtorë teknik që kemi menduar që do ta plotësojë atë vakumin që do të krijohet në raste emergjente ose në këto raste të tashme se kemi në arsim ka raste më besoni thotë 'nesër shkova' ose pranohet diku në Prishtinë, edhe ta lë vendin vakant, nuk është lehtë me e zëvendësuar, kemi probleme jashtëzakonisht të mëdha sepse nuk janë të inkorporuar as Ligji i Punës me Ligjin për Arsimin Para universitar d.m.th ish dashtë edhe ato me e pasur një inkornorim mes vete, pra i kemi këto probleme të cilat i rrahim në mënvërvë të vazhdueshme në kolegjiume për drejtorë të arsimit në nivel të Kosovës. Sa i përket lyerjes së objekteve shkolllore, unë besoj se pjesa më e madhe që ish dashtë të përfundojë me lyerjen e atyre objekteve është përfunduar. Shkolla e Kaliqanit është lyer tërësisht, kemi intervenuar në shumë vende, kemi intervenuar me të gjitha nyjet sanitare e kemi qit një tender me procedurë me procedurë të shkurtër se të gjitha nyjet sanitare janë rregulluar, nuk ka vend në shkollë që pikon ujë për momentin, tani e kanë edhe tenderin për mirëmbajtjen e shkollave, kanë mjete të mjaftueshme, unë besoj që vetëm duhet vullnet, njëherit ju falënderojë të gjithëve edhe mësimdhënësit edhe prindërit edhe nxënësit edhe drejtorët edhe punëtoret teknik se kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm këto ditë. Sa i përket task forcës komunale, është e formuar në bazë të master planit Qeverisë së Republikës së Kosovës. Po ju them lirisht që është mirë që së bashku të qesim problemet e Arsimit në tavolinë jam i gatshëm të punojë me gjithsecilin. Ka probleme jo veç te ne por ka çdo kund, edhe nuk është lehtë me e monitoruar Arsimin mirëpo jemi duke u mundur të bëjmë aq sa mundemi sikur me staf, sikur ne terren, sikur me drejtorë, sikur me të gjithë.

**Labinot Aliaj**, drejtor e pata edhe një pyetje unë, se nuk mora përgjigje lidhur me testimet.

**Hajrush Shoshi**, kërkesa për testimet e para ka ardhur nga Instituti, dhe është kërkuar që të përzgjidhen 50 mësimdhënës të Komunës së Istogut, kështu që duke e parë situatën çfarë e kemi po ti kishim zgjedhë nga të gjitha shkollat nga një, ndoshta nuk kishim pasur mundësi me parë asnje rezultat si duhet. Dhe kemi vendosur që t'i testojmë nga 10 mësimdhënës të shkollës 'Bajram Curri' gjimnazit 'Haxhi Zeka' çerdhes së fëmijëve, shkollës 'Mithat Frashëri' edhe shkollës 'Martin

Camaj'. Të gjithë mësimdhënësit kanë ardhur të përzgjedhur nga drejtorët e shkollave. Asnjë emër drejtoria komunale e arsimit nuk e ka dërguar. Kështu që ne i kemi mbledhur, nëse dikush atje ka bërë politikë, le ta marrë përgjegjësinë për veti. Lirisht mund të ju them se të gjithë emrat i kanë zgjedhur drejtorët e shkollave. Nuk e besoj që duhet të jetë ajo çështje politike kur ne kemi menduar në fillim që bukur problem me e caktuar dikë pse po e dërgojmë me e bërë testin.

**Kryesuesi**, Labinot e more përgjigjen. Eliot Kukiqi, e ka fjalën.

**Eliot Kukiqi**, përshëndet të gjithë të pranishmit! Sa e dëgjova raportin e drejtorit, drejtori nuk e ceku në raport se a kanë profesorët orar të rregullt a kanë mbi normë, dhe mendoië një profesor që mban orë mbi normë nuk mund të jetë cilësor. A po mendoni të futni kuadër të përkohshëm ndihmës, dhe në rast nevoje a keni mekanizëm për mbikëqyrjen e mësimit online nëse do të ndodhë në të ardhmen. Faleminderit!

**Kryesuesi**, faleminderit Eliot! Pate dy pyetje konkrete. Arben po ta jap fjalën veç ta kemi pak parasysh kemi një pikë të rendit të ditës mund të lajmërohemë në së shumti dy herë ta respektojmë pak edhe Rregulloren. Atë çka e ke ndërmend thuaje, urdhëro!

**Arben Kabashi**, për ata po e marrë fjalën me e thënë atë çka e kam për ta thënë. Unë më shumë për sqarim, është e vërtetë ajo që me Agronin gjeta bashkëpunim për një temë të caktuar që një drejtorët i caktuar të raportojë në Kuvend krejt mirë. Por nuk gjeta temën çka me diskutuar d.m.th që ti po propozon me marrë një vendim diçka, thjeshtë kjo më shumë më ngjau mua politike në atë aspekt e thashë. Edhe dallon raportimi me një vendim. Seanca e jashtëzakonshme thirret në atë kuptimin që t'i po e propozon me e marrë një vendim kështu thirret, e në kuadër të saj mua më pëlqeu ajo ideja qe e dha që në fakt në këtë rast u dashtë me e propozuar ai që e ka iniciuar për me e thirr mbledhjen e jashtëzakonshme me e themeluar një komision në qoftë se ke dyshime për diçka në kuadër të Asamblesë Komunale që me i verifikuar këto probleme çka janë edhe me i diskutuar në Asamble. Ka mundur të jetë një ide më e mirë me propozuar dhe me e marrë një vendim, për formimin e një komisioni të anëtarëve të Kuvendit ama gjithçka jemi bashkëpunues, këtë e thash në fillim. Faleminderit!

**Kryesuesi**, dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Naim Behlulaj është lajmëruar!

**Naim Behlulaj**, përshëndet të gjithë të pranishmit! Pasi që vij nga kjo lëmi nga arsimi, do të ndalem pak te zhvillimi i Arsimit në Komunën e Istogut pa dashtë me e përkrahë as drejtorin as askënd por me e thënë realitetin. U përmend se punohet me tri ndërrime, nxënësit kanë kontakt ndërmjet vete, sa për informim, unë punojë vij prej dy shkollave Gjimnazi "Haxhi Zeka" dhe "Tre Dëshmorët" asnjë nxënës nuk ka kontakt ndërmjet vete ndërrimi me ndërrim. Orari i parë fillon prej 08:00 -11:00 orari i dytë fillon prej 11:30-14:30 dhe orari i tretë fillon në ora 15:00-17:55 d.m.th nxënësit e kanë gjysmë ore, kur ne si mësimdhënës nuk i lejojmë nxënësit të qëndrojnë në oborrin e shkollës ku janë të njofuar edhe Policia me orar. Sa i përket institucionit arsimor në Gjimnaz nuk ka, ndërsa sa i përket higjenës, e gjitha këto janë në shkolla të bollshme, pasi prapë po them që vij prej aty edhe e di, kam vizituar edhe shkolla të tjera, është "Ndre Mjeda" në Rakosh, "Mehmet Akif" në Shushicë është Gjimnazi "Haxhi Zeka" dhe "Tre Dëshmorët" në Uçë. Gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit e mbainë distancën dhe komfor rregullave të Institutit të Shëndetësisë vazhdoinë t'i zbatojnë. Për udhëtim kemi pak problem në Rakosh, Uçë, Kërrninë, në pjesën e ndërrimit të dytë, jo që kemi nxënës shumë por janë pak nxënës 4 ose 5, edhe nuk po ka mundësi as autobusi me shkuar e me i dërguar për 4-5 nxënës kjo është arsyja. Ndërsa sa i përket këshillit drejtues të shkollave, apo këshillit të prindërve unë jam vet anëtar i këshillit dhe funksionon për dy shkolla që unë e di Gjimnazi "Haxhi Zeka" dhe "Tre Dëshmorët" funksionojnë sidomos në kohën e pandemisë tash e kemi filluar mësimin janë shumë aktiv. Ndërsa drejtorit, stafit edhe këtyre i falënderojmë për punën që e kanë bërë edhe për punën që do ta bëjnë gjatë kësaj periudhe. Faleminderit!

**Kryesuesi**, faleminderit Naim! Është lajmëruar Mirushe Sadikaj pastaj Selajdin Bytyçi.

**Mirushe Sadikaj**, përshëndetje për të gjithë! Unë pata me u ndërlidh me këtë temë sepse pasi që i përkas kësaj lëmie dhe punojë në Arsim, atëherë kisha me e vlerësuar gjendjen edhe mendojë që ky raportim ka qenë i mirë o vetëm për ne këtu por për të gjithë qytetarët e Istogut sepse janë njofuar të gjithë prindërit sidomos prindërit, të cilët njoftohen për fëmijët e tyre edhe e dinë saktësish gjendjen në Arsim, dhe jo vetëm me fjale goje tha ky e tha ai. D.m.th mendojë që ka qenë një punë e mirë që është bërë për raportimin e kësaj gjendje, unë po nisem prej shkollës "Mithat Frashëri! Në Gurrakoc në të cilën punojë edhe i shoh për çdo ditë edhe jam pjesë e saj se po bëhet një punë e mirë, një punë e palodhshme i gjithë stafi është i gatshëm, edhe gjithë mësimdhënësit të cilët janë kujdestar dite atëherë kanë me qenë në shkollë 20 minuta para fillimit të mësimit edhe ndërrimi ndërmjet ndërrimit është 45 minuta. D.m.th. ne i kemi dy ndërrime, ndërrimi i parë dhe e dytë d.m.th është kohë e mjaftueshme me bërë dezinfektimin e klasave dhe korridoreve, për çdo ndërrim

bëhet dezinfektimi edhe nëpër klasa janë pastruesit teknik mirëpo ata që kanë qenë nuk është rritur numri i tyre, ndoshta nuk është i mjaftueshëm, mirëpo sa për fillim po bëhet një punë e mirë, edhe ekziston këshilli i prindërve edhe task forca se kanë mbledhje dy herë në javë në shkollë edhe për çdo situatë reagojnë edhe dezinfektues ka mjaftueshëm, shikohet çdo pushim a janë dezinfektuesit e mbushur edhe secili mësimdhënës e ka për detyrë t'i plotësojë ato të meta që shihen çdo pushim. Edhe drejtoresha e bën një punë të palodhshme që nga ndërrimi i parë e deri te i fundit, kontrollon për çdo orë në secilin kat mirëpo sa i përket distancës mes nxënësve është e pamundur të mbahet distanca ashtu siç dëshirojmë ne edhe siç duhet, sepse nxënësit edhe distancën në klasë nuk kanë mundësi me e mbajtur 1 metër e gjysmë. Edhe faktikisht secili mësimdhënës kur te del nga mësimi që është pushimi 5 minuta ata faktikisht bashkohen nxënësit është e pamundur me i larguar, në atë 5 minutësh ata bëhen bashkë edhe ne autobus ashtu ka mundësi, mirëpo mendojë që është duke u bërë një punë e mirë, secili individ ka përgjegjësi për vete edhe për klasën edhe për shkollën duhet me u kuidas përvete duhet me u nisur nga familia sense familia merret me të edhe nëse mbahet maska atëherë nuk kemi me pasur problem. Edhe diçka për mësimdhënës që pyeti kolegu ka mësimdhënës që nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore, e sidomos ne i kemi 2 mësimdhënës të cilët kanë probleme shëndetësore edhe ata punojnë prej fillimi vazhdimisht, ndoshta ka qenë mirë për ta me menduar një herë për një herë pasi që situata është mirë, mirëpo nëse ndodhë diçka, atëherë kishte me qenë mirë që ata me pasur zëvendësues, janë disa mësimdhënës që kanë orë më shumë se çka është e paraparë, mirëpo për shkak se është dashtë me i ndarë disa klasë të cilat kanë numër të madh të nxënësve. Deri tash është mirë, kishte me qenë mirë nëse një mësimdhënës ka probleme, ka simptoma, menjëherë t'i bëhet testi e jo të shkojë një javë ose dy a tri deri sa t'i bëhet testi atëherë kur t'i kryhet krejt me thënë e ka pasur virusin edhe mos të ketë zëvendësim. Mjafton një mësimdhënës me e humb një javë ose dy ose tri. Kaq kisha, faleminderit!

**Selajdin Bytyçi**, përshëndet të gjithë të pranishmit! Pak si u shtjerrë debati me të gjitha këto sugjerime e konstatime, unë e përshëndes drejtorin që na e paraqiti një raport, në fakt ne e kemi pasur një raport para dy mbledhjeve për përgatitje për fillimin e viti shkollor, me të vërtetë ai raport ka qenë shumë i saktë, me informata shumë të qarta. Ne jemi pajtuar edhe me përgatitjet që i ka bërë drejtorati për fillimin e viti shkollor, normalisht këtë ja ka mundësuar infrastruktura e mirë që është bërë në Komunë të Istogut, nuk kemi mungesë të objekteve shkolllore as të hapësirave kështu që si drejtorat ka bërë përgatitjen e vet për tri opsonet për fillim të viti shkollor. Tash para fillimit të viti shkollor 14 shtator Ministria e Arsimit ka pasur obligim edhe i ka bërë monitorimet e të gjitha objekteve shkolllore dhe ja u ka dhënë dritën e gjelbër për fillimin e viti shkollor. Tash me 14 shtator fillon viti shkollor dhe gjërat që shkruhen dhe gjërat që janë në terren normalisht që pak ndërrojnë. Mentaliteti jonë është i tillë që është e pamundur që fëmijët parashkollar ose fëmijët e vegjël 7-8 vjeçar që ata ta kontrollojnë distancën, ta mbajnë maskën,

këto janë sfida të përbashkëta edhe unë e kam bërë një renditje prind-nxënës-mësimdhënës. Prindi është ai i pari që duhet të interesohet për fëmijën e vet, si udhëton a e mban maskën a e ruan distancën dhe si sillet në shkollë, nxënësi për vvetveten e tek mësimdhënësi. Tani shihet këtu si pas raportit të drejtorit që është një kontroll e rreptë prej Ministrisë së Arsimit d.m.th çdo lëvizje çdo raport ditor që vjen duhet me u njoftuar të gjithë për gjendje aktuale edhe këtë është duke e bërë drejtorati i Arsimit, edhe unë e përshëndes drejtorin se në një lloj forme e kupto edhe presionin në cilin është, ne jemi këtu pak me lehtë mirëpo unë e di se çfarë presioni ka në drejtorat të Arsimit çdo ditë, përgjegjësia tyre që është për mbarëvajtjen e mësimit. Pra siç e thashë kjo është një sfidë e përbashkët nuk na përjashton asgjë që ne mos të jemi të inkuadruar që të kontribuojmë edhe ne për mbarëvajtjen e mësimit d.m.th kontakti me qytetarë, edhe vet jemi prindër që t'i njoftojmë ata për mundësitë që duhet të jenë më të mira për përcjelljen e tyre në shkolla, plus asaj kisha ftuar që edhe mediat lokale që janë të krijojnë një hapësirë ~~nuk di a janë duke e bërë por ta krijojnë një hapësirë të vecantë për mbarëvajtjen e mësimit~~ në shkolla të Istogut, për sjelljen e fëmijëve për këshillat ndaj situatës që e kemi. Kështu që i përshëndes të gjithë që kanë kontribuar në këtë mbledhje të jashtëzakonshme, ndoshta është dashur ta them në fillim por po e them tash në fund herën e kaluar e kemi pasur një mbledhje të jashtëzakonshme, tash një mbledhje të jashtëzakonshme, pse po thirrin disa për nënshkrim të inicimit të mbledhjes së jashtëzakonshme e nuk po thirret gjithë, pavarësisht a e nënshkruajmë ne a jo. Ish dashtë edhe Arbeni herën e kaluar edhe Agroni tash me na njoftuar, se unë nuk kam pasur informatë, tjetër gjë është çfarë qëndrimi mbaj po mos të na anashkalojnë në një lloj forme.

**Kryesuesi**, dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Labinot Aliaj është lajmëruar.

**Labinot Aliaj**, nuk dua ta zgjas shumë, vetëm desha të ndërlidhem te ftesa që e kemi marrë d.m.th me u nënshkruar për këtë thirrje të mbledhjes, desha me e falënderuar Agronin për këtë hap është hap i mirë ashtu siç tha edhe profesoresha kanë mundësi një raportim të detajuar në çdo pikë ta shohin qytetarët e Istogut nga drejtori. Mua më gjzon ky fakt, që mundemi me e pasur një raportim kaq të mirë në detaje kështu që e falënderojë edhe drejtorin për këtë raportim, dhe kaq kisha për sot.

**Kryesuesi**, faleminderit Labinot! Urdhëro drejtor mbete diçka borxh ndonjë sqarim.

**Hajrush Shoshi**, Eliotit desha të ju përgjigjëm rrëth mbi normës që po mendon se janë duke e bërë mësimdhënësit, për ata Ministria e Arsimit ka llogaritur që ora të jetë 30 minuta apo edhe 20 minuta, në raste që jemi duke e mbajtur në Gjimnazin "Haxhi Zeka" d.m.th. 25 minuta, prandaj është reduktuar që të kemi mundësi me mbajtur me dy grupe. Nuk është mbi normë, d.m.th e njëjtë klasë ndahet në dy grupe, i njëjtë plan program. Sa i përket organizimit të mësimit online Ministria e Arsimit ka paraparë dhe i ka ndarë diku 2 milion e 600 mijë euro për me e blerë një platformë e cila do të shërbejë nëse ka nevojë. Për momentin në tender Komuna e Istogut e ka një tender për pajisje teknologjike për shkollën e mesme tekniqe "Mithat Frashëri" diku afér 20 mijë euro, e pashë dje që janë alokuar edhe 100 mijë euro që i ka ndarë kryetari d.m.th edhe atë tender do ta publikojmë shumë shpejt që të gjitha këto mjete të shkojnë në pajisje teknologjike. 64 mijë euro për mirëmbajtje, për dezinfektim, për mësimdhënës shtesë edhe ato janë alokuar javën e kaluar, dhe besojë që do të ja dalim deri në fund. Kam edhe një informatë që ka ardhur dje prej Ministrie~~s~~ shumë shpejt do t'ë na ftojnë diku për 150 inad që t'ë na dhurojnë 50 vetëm i kemi të dhruuar nga USAID-i, edhe Ministria e Arsimit e ka një tender në procedurë diku 800 mijë euro që edhe ato pajisje do të ndahan për kokë të nxënësit. D.m.th në nivel të Kosovës aty kemi hise edhe ne, të cilën shumë shpejt edhe do të disponojmë edhe me ato pajisje. Faleminderit!

**Kryesuesi**, faleminderit drejtor! Dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Njomza Demaj është lajmëruar.

**Njomza Demaj**, përshëndet të gjithë të pranishmit! Pasi që i përkas edhe unë lëmisë së Arsimit, desha me treguar që është ka bëhet një punë e mirë edhe në shkollën "Hysni Zajmi" në Vrellë. Menaxhimi i situatës me Covid-19 deri diku po shkon mirë, nxënësit distancën po e mbajnë, ne nuk kemi numër të madh të nxënësve d.m.th mbi 20 asnjë nuk e ka tejkaluar, jemi duke e menaxhuar mirë, edhe si task forcë po funksionon, mbledhjet mbahen me rregull, edhe këshilli i prindërve po funksion në shkollë te ne, edhe gjithçka është në rregull. Bashkëpunimi me Kuvendin Komunal gjithashtu është në rregull, jemi furnizuar me materiale higjenike me të gjitha këto me kohë, me termometër laserik matet temperatura çdo ditë, të gjitha këto janë në rregull kështu që kaq pata unë.

**Kryesuesi**, faleminderit Njomza! Agron Avdijaj e ka kërkuar fjalën.

**Agron Avdijaj**, meqenëse u zhvillua gjithë ky debat, për mirë apo për keq po del që nuk është krejt e pazakontë se pse është thirre kjo seancë. Ne nganjëherë seancat e rregullta për 1 orë e gjysmë i përfundojmë krejt, që d.m.th po demantohet ajo që nuk

ka pasur nevojë të thirret seanca e jashtëzakonshme, kjo është e para që desha me e thënë. E dyta desha me i falënderuar të gjithë ata që e kanë nënshkruar, por edhe që me ju kërkuar falje atyre që nuk ja kam dhënë për nënshkrim që potencialisht kanë mundur me nënshkruar. Propozimi i drejtorit me krijuar një task forcë, një ekip nga Kuvendit Komunal me i vizituar shkollat, unë tu e parë që më është dukur përveç meje dhe dy tre që patën dilema, të gjithë qenkan mirë, nëse çdo gjë është mirë atëherë si Kuvendi pse keni nevojë me përkrah nëse nuk është mirë, edhe një komision të tillë. Pak a shumë ishin këto, seancat e jashtëzakonshme, unë nuk dua të pajtohem që në seancë të jashtëzakonshme patjetër duhet me marrë vendim, në seancat e jashtëzakonshme ligji parashev edhe raportim, d.m.th kur ka situatë sikur kjo e pandemisë nuk është e zakonshme. D.m.th kjo ishte ajo që pata me e thënë. Faleminderit!

**Kryesuesi**, Naim Behlulaj e ka fjalën.

**Naim Behlulaj**, desha me ju përgjigjur Labit që tha u bë testimi politik. Veç besoni që nuk është bërë, se nëse kishte qenë me testim politik isha testuar unë.

**Kryesuesi**, Selajdin Bytyçi e ka fjalën.

**Selajdin Bytyçi**, tash hapet çështja a duhet me u konkluduar diçka a duhet me marrë ndonjë vendim. Unë një mendim e kisha thënë në emër tim, mirëpo edhe nëse anëtarët tjerë të asamblesë e aprovojnë ajo është krejt në rregull. Si konstatim: të gjithë anëtarët e asamblesë komunale janë në dispozicion për çka ka nevojë përmbarëvajtjen e mësimit. Një konstatim i tillë. Faleminderit!

**Labinot Aliaj**, veç desha një kundër reagim se Labi nuk tha që janë bërë por raportim në media, në mediat lokale ka pasur raportim.

**Kryesuesi**, dikush tjetër a e dëshiron fjalën? Jo. Konsiderojë që është bërë një debat i frytshëm për gjendjen në arsim, po ashtu edhe një raport i qartë, i thuktë me përbajtje lidhur me situatën në shkollat tonë të Komunës tonë, lidhur me gjendjen aktuale në këtë situatë pandemie. Mendojë që përveç që u njoftuan ne këtu se bashku dhe debatuam, është pozitive që e tha edhe dikush që janë njoftuar me gjendjen edhe nxënësit, prindërit, në përgjithësi qytetarët e territorit të Komunës tonë. Do të ndalemi në dy konstatime. Drejtori e përmendi, na ftoi në një lloj forme.

Unë pyes anëtarët e Kuvendit edhe mendojë që është e mirë një grup që në vete përmban anëtarët e Kuvendit nga të gjitha subjktet politike të organizohen të shkojmë në vizitë sidomos në disa shkolla të mëdha. Dhe aty të bindemi edhe vet ne konkretisht për gjendjen. Unë ju pyes juve a do të pajtoheni me këtë propozim që e bëri drejtori? E mbështes unë! Mund ta formojmë një ekip të shkojmë një ditë t'i vizitojmë mësimdhënësit edhe me e parë gjendjen, nëse ju mendoni që është e udhës, që ku jemi mund ta formojmë. Nën 2: bazuar në debatet që u dolën unë e kam vërejte që do ta keni, drejtori e ka, gjithashtu edhe kryetari, edhe komiteti për Arsim ka mbajtur takimet e veta, edhe në muajin e kaluar edhe këtë muaj, ka dhënë edhe sugjerimet e veta, të premten e kaluar e ka mbajtur një takim, unë për së shpejti vetëm rekomandimet i mora sot procesin jo. 1-2 rekomandime janë edhe nga ana e komitetit që u potencuan edhe këtu. Problemi është të lëvizja e nxënësve për të cilën ndoshta mund ta shohim mundësinë së bashku me ekzekutivin me pronarët e kompanive si mund të gjendet një mundësi që ata të ndihmohen pak e ata të ju ~~nësimtarëve~~ ~~që~~ ~~ne~~ ~~kontrollon~~ ~~e~~ ~~tyre~~ transportuese sa më pak nxënës, e sa më shumë t'i afrohemë plotësimit të kriterit edhe pse është e pamundur. D.m.th një konkluzion i tillë kishte mundur me dalë edhe nga të gjithë ne këtu që drejtori i Arsimit, në përgjithësi ekzekutivi të shikojnë mundësinë e shtimit të vijave transportuese përndryshe nuk mund të mënjanohet ajo është problem.

**Agron Avdijaj**, realisht ky ishte propozimi edhe kur e lexova nëse më keni dëgjuar me vëmendje.

**Kryesuesi**, u debatua këtu shumë, unë mendojë dhe jam ithtarë shumë i asaj që këshillat në shkolla janë shumë të domosdoshme, këshillat e prindërve janë edhe me rregulla normative, bazuar në atë që e di, edhe drejtori e tha, e thanë edhe disa mësimdhënës këtu, ato janë funksionale, por asgjë e keqe nuk bëhet kur bëhet thirrje që të ngritët efikasiteti i punës dhe të ndihmojnë edhe më tepër, por edhe ne edhe këshilli i arsimtarëve edhe drejtoritë të marrin edhe sugjerimet e tyre edhe të jenë sa më funksional këshillat e shkollës. Mendojë që asgjë nuk është e dëmshme, një thirrje nga Kuvendi, që këshillat e shkollës aty ku çalojnë të funksionalizohen d.m.th të ngritët niveli i funksionalizimit të tyre besoj që në këtë mënyrë mund ta formulojmë. Unë nuk kam diçka tjetër, nëse ju mendoni me këto pak fjal që i thashë, si konkluzione mund t'i nxjerrim. A e dëshiron dikush tjetër fjalën? Jo. Mendojë që është debatuar mjaft rreth kësaj, nuk është e tepërt edhe një herë po them kur flasim për çdo ditë kur do që takohemi, jo në një mbledhje të tillë ku edhe gjithë qytetarët janë në përcjellje, shumica së paku, por edhe kur takohemi vet i dyti a i treti dhe bisedojmë për problemet e Arsimit nuk janë të tepërtë kur e kanë synimin e mirë edhe qëllimin e mirë. Ju falënderojë për pjesëmarrje dhe e mbylli këtë takim të jashtëzakonshëm!

Ju faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në takimin e ardhshëm.

Mbledhja përfundoi me punë në orën 11:40.

Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Qaush Balaj

